



Kanton Zürich
Bildungsdirektion
Volksschulamt
Pädagogisches, Unterrichtsfragen

Kontakt: Volksschulamt, Pädagogisches, Unterrichtsfragen, Walchestrasse 21, 8090 Zürich
Telefon 043 259 22 62, paedagogisches@vsa.zh.ch (sco)
29. September 2020
1/1

Përkujdesja plotësuese shkollore për fëmijët (Unterrichtsergänzende Kinderbetreuung)

Informacione të shkurtra për prindërit mbi ofertat e mundshme

Familja ditore (Tagesfamilie)

Në një familje ditore fëmija Juaj ka përkujdesje si në familje. Aty ka shpesh edhe motra dhe vëllezër ditor me të cilët mund të luajë dhe të harliset. Ju dhe familja ditore merreni vesh për kohët e përkujdesjes për fëmijën dhe atë sipas dëshirave dhe nevojave Tuaja.

Tryeza e drekës (Mittagstisch)

Kjo ofertë përkujdesjeje i ofron mundësinë fëmijës Tuaj që ta hajë drekën së bashku me fëmijët e tjerë dhe ta kalojë kohën e lirë së bashku me ta. Tryeza e drekës mund të shfrytëzohet nga e hëna deri në të premten apo vetëm për ditë të caktuara.

Streha ditore e përkujdesjes/ Klubi i nxënësve (Kinderhort/Schülerclub)

Strehët ditore për fëmijë janë institucione që ofrojnë përkujdesje profesionale për fëmijët e kopshtit dhe ata të shkollës fillore. Fëmijët dhe personeli i përkujdesjes kalojnë kohën e lirë pas mësimit kryesisht në grupe prej diku njëzet fëmijësh të moshave të ndryshme. Përkujdesja mund të jetë tërë ditore nga e hëna deri të premten apo vetëm në disa ditë të caktuara dhe të zgjidhet në mëngjes, në mesditë apo pasdites.

Shkolla ditore (Tagesschule)

Të gjithë fëmijët nga fillimi e deri në fund të mësimit qëndrojnë për disa ditë në javë në shkollën ditore. Koha e pritjes para fillimit të mësimit përkatësisht ajo e kthimit pas përfundimit të mësimit mund të rregullohen ashtu që të shfrytëzohen individualisht.